



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201500496/2

Tiranë ____/____/2015

Lënda: Rekomandojmë *"Propozime për shtesa dhe përmirësime në nenet 48, 58 dhe 326 të Kodit të Procedurës Penale, për vendosjen e avokatit mbrojtës në procedimin dhe gjykimin penal për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshëm të viktimës, si dhe ankimit në gjykatë ndaj vendimit të pezullimit të hetimeve, marrë nga organi i Prokurorisë"*.

Drejtuar : Ministrit të Drejtësisë
Z.Nasip NAÇO

TIRANË

Për dijeni: Kryetarit të Komisionit Parlamentar të Çështjeve Ligjore,
Administratës Publike dhe të Drejtat e Njeriut
Z. Fatmir XHAFA

KUVENDI

TIRANË

Të nderuar Zotërinj,

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës të Institucionit të Avokatit të Popullit në vite, qytetarë të ndryshëm, pjestarë të familjeve të viktimave apo viktimë të dhunës në familje dhe të trafikimit, kanë paraqitur me shqetësim shkelje të të drejtave të tyre në hetimin apo gjykimin e procedimeve penale ndaj autorëve të krimit.

Ankesat e qytetarëve kanë qënë kryesisht për rastet kur, nga kryerja e veprave penale kanë ardhur pasoja të rënda në humbjen e jetës së familjarëve, sidomos

për krimin e “Vrasjes”, “Shkeljes së Rregullave të Qarkullimit rrugor”, Mjekimit të pakujdesshëm” me pasojë vdekjen, ose të viktimave nga “Dhuna në familje”, “Trafikimi i femrave” etj, të cilat kanë qënë evidente, të bëra publike dhe shqetësuese për mbarë opinionin shoqëror.

Shqetësuese kanë qënë dhe rastet, kur nga kryerja e veprave penale kanë ardhur pasoja të rënda në dëm të jetës së një grupi personash nga ngjarje të bujshme si, ajo e “Tragjedisë së 9 Janarit të vitit 2004”, “Ngjarja e Gërdecit 2008”, “Ngjarja e 21 Janarit 2011” etj.

Për këto raste të bëra publike dhe nga mediat, Avokati i Popullit i ka filluar me inisiativë ato, duke ndërmarrë kryerjen e një hetimi të pavarur administrativ. Nga trajtimi i këtyre rasteve është konstatuar se qytetarët kanë pamundësinë ligjore për të mbrojtur interesat e tyre të ligjshme para organeve të drejtësisë.

Konstatime dhe opinione

Argumentat që mbështesin sugjerimin tonë, paraqiten si më poshtë:

Së pari: Mangësia ligjore e parashikimit të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të ligjshëm të viktimave, çka konsiston në mospjesëmarrjen e avokatit mbrojtës qysh në kryerjen e veprimeve të para hetimore, të cilat shpesh paraqiten me mangësi të theksuara e mungesë profesionalizmi si, kqyrja e vëndit të ngjarjes, kqyrja e viktimës, marrja dhe sekuestrimi sendeve prova materiale, mjeteve të kryerjes së krimit. Këto veprime procedurale hetimore janë të domosdoshme e të papërsëritshme, dhe mangësitë e sipërpërmëndura kanë bërë që jo në pak raste, mënyra e përfundimit të çështjes në drejtim të zgjidhjes së saj nga organi i Prokurorisë ka lënë për të dëshiruar, pasi është vepruar në mënyrë të njëanshme dhe subjektive.

Së dyti: Gjatë fazës së hetimit paraprak apo gjykimit të çështjeve penale, nuk merren dhe vlerësohen deklaratimet apo pretendimet e familjarëve të viktimave “Kërkesa apo memorie me shkrim”, për dijeninë që ata kanë për rrethanat e ndodhjes së ngjarjes kriminale, personin konkret si autor i mundshëm i veprës penale etj. Kjo, dhe moskryerja në disa raste e hetimeve të plota e të gjithanshme e çështjeve penale, ka sjellë për pasoja që organi procedues të marrë vendim për pushimin e çështjes penale, apo pezullimin e hetimeve.

Së treti: Nga organi procedues në pjesën më të madhe të procedimeve penale të hetuara, familjarët e viktimave nga vepra penale, viktimat e dhunës në familje apo të trafikuar, nuk janë informuar për të drejtën që ata gëzojnë për ngritjen e padisë civile në procesin penal, e cila parashikohet në nenin 61 të Kodit të Procedurës Penale. Për rrjedhojë, palët e interesuara, të dëmtuara nga vepra penale, kërkesën për shpërblimin e dëmit të shkaktuar e kanë paraqitur në gjykatë me padi më vete, bazuar në nenin 640 e në vijim të Kodit Civil të Republikës të Shqipërisë.

Së katërti: Për rastet e Gjykimeve të Posaçme, siç është dhe Gjykimi i Shkurtuar, në veprimtarinë e punës së organit të Prokurorisë ndodh që mund të gabohet në përcaktimin e faktit ose të veprës penale, kurse familjarët e viktimave duke mos marrë pjesë në séancën gjyqësore nuk marrin dijeni për akuzën konkretë dhe rrethana të tjera që lidhen veprës penale si motivin e

kryerjes së saj etj. Megjithatë, gjykata bazuar në nenin 406 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur gjykimin e shkurtuar në gjëndjen që ndodhen aktet, duke favorizuar të pandehurin me uljen e 1/3 së dënimit me burgim. Ky veprim ka sjellë për pasojë faktin që familjarët e viktimës të mos informohen me rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, motivet dhe qëllim e kryerjes së saj, bashkëpunëtorët, apo llojin dhe masën e dënimit të dhënë ndaj autorit. Jemi të mendimit se gjykata të zbatojë dispozitat procedurale përkatëse, dhe kur ajo të pranojë kërkesën e të pandehurit për gjykim të shkurtuar, faktikisht duhet të bindet se mund të përfundojë çështjen në gjëndjen që janë aktet, por duke patur të konfirmuar qëndrimin e të pandehurit për veprën penale të kryer, dhe motivet e kryerjes së saj.

Së pesti: Është rasti i njohur, por i veçantë si precedent në praktikën gjyqësore të vëndit tonë, pjesëmarrja e avokatit mbrojtës z.Nazif Bezhani, në përfaqësimin e 4 viktimave të ngjarjes së 2 Prillit 1991, e ndodhur në qytetin e Shkodrës edhe pse nuk ishte e parashikuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

Legjislacioni procedural penal dhe aktet ndërkombëtare

Respektimi i të drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur gjatë shqyrtimit të çështjes penale janë elementë bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për një proces të rregullt ligjor, si një e drejtë themelore e përgjithshme, cënim i së cilës konsiderohet si shkelje e parimeve kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në disa raste të gjykimeve të çështjes penale, (Vendimi i Gj.K.Nr.9, datë 09.05.2005, Vendimi i Gj.K. nr.4 datë 10.02.2012 etj) ka vlerësuar se e drejta e palëve për të qënë të pranishëm dhe për t'u mbrojtur në proces gjyqësor janë aspekte të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Gjykata e ka pranuar ekzistencën e mbrojtjes si tregues thelbësor të zhvillimit të një procesit të rregullt gjyqësor. Që e drejta e mbrojtjes të jetë reale dhe efektive dhe jo vetëm teorike, ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por përkundrazi gjykata duhet të marrë të gjitha masat ligjore që, në funksion të procesit të drejtë, jo vetëm të sigurojë praninë e mbrojtësit në gjykim, por dhe t'i japë atij mundësinë të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar barazinë e armëve. Kjo kërkon që palët në procesin penal të vihen në kushte të barabarta, të kenë të njëjtat mjete të barabarta, mundësi për të dhënë shpjegime para gjykatës, për të paraqitur prova dhe asnjë provë të mos ketë vlerë të paracaktuar më të madhe se tjetra, palët duhet të njohin provat e njëra tjetrës dhe gjykata t'i vlerësojë ato në tërësinë e tyre.

Gjykimi i drejtë duhet të nënkuptojë të drejtën e gjithkujt, pra si të akuzuarit penalisht ashtu dhe personave të familjeve të viktimave, apo të dëmtuarve nga kryerja e veprës penale. Standartet e procedimit dhe gjykimit që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor duhen parë dhe trajtuar në aspektin e detyrimeve që i ngarkon gjykatave respektimi i të drejtës së mbrojtjes, si një e drejtë themelore e individit.

Në nenin 42 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë parashikohet se: *“Liria, prona dhe të drejtat e njohura me kushtetutë dhe ligj, nuk mund të cënohen pa një process të rregullt ligjor. Kushdo për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjor ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik, brënda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”*.

Në nenin 10 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut”, datë 10 Dhjetor 1948 thuhet: *“Çdokush ka të drejtë të barabartë të dëgjohet, drejtësisht e publikisht, nga një gjykatë e pranuar dhe e pavarur, në mënyrë që të merret një vendim mbi të drejtat dhe detyrimet e tij, apo mbi akuzat penale të ngritura ndaj tij”*.

Kurse në nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut thuhet se : *“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brënda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet civile ashtu dhe për bazueshmërinë e çdo akuze të natyrës penale që i drejtohet”*.

Në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995, i ndryshuar, Kodi i Procedurës Penale neni 1 thuhet se : *“Legjislacioni procedural penal ka për detyrë të sigurojë një procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, të mbrojtë liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshme të shtetasve, të ndihmojë për forcimin e rendit juridik, dhe zbatimin e Kushtetutës e të ligjeve të shtetit”*.

Pra, legjislacioni procedural penal i brëndshëm dhe aktet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përcaktojnë në mënyrë eksplicite të drejtën e personit të akuzuar për t’u mbrojtur gjatë hetimit e gjykimit vetë apo me anë të një mbrojtësi, si dhe për të patur një proces të rregullt ligjor.

Në pikën 1 të nenit 148 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë thuhet: *“Prokuroria ushtron ndjekjen penale si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit....”*. Sipas këtij përcaktimi organi i Prokurorisë ka disa veçori të përcaktuara në Kushtetutë dhe ligj, të cilat e vendosin këtë organ në një pozitë të dallueshme nga pushtetet e tjera dhe veçanërisht si organ i vetëm që ushtron ndjekjen penale; si organ që përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, si organ me pavarësi të plotë në ushtrimin e funksioneve dhe si një organ i centralizuar që funksionon sipas rregullit, se urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit më të lartë janë të detyrueshem për prokurorët më të ulët.

Pra, është organi i Prokurorisë ajo që përfaqëson akuzën në gjyq në mbrojtje të drejtave dhe interesave të palës së dëmtuar nga vepra penale në procesin penal.

Por, si përmendëm më lart, legjislacioni procedural penal nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë e cila të parashikojë marrjen nga familjarët e viktimave nga vepra penale të avokatit mbrojtës, me qëllim mbrojtjen e interesave të tyre. Nga ana tjetër, rezulton se në veprimtarinë e punës gjatë ushtrimit të detyrës organi procedues jo gjithmonë i mbron dhe realizon këto të drejta me objektivitet dhe profesionalizëm. Këto kanë qënë dhe arsyet që familjarët e viktimave nga veprat penale i janë drejtuar me ankesë Institucionit të Avokatit të Popullit, duke kërkuar ndihmë dhe ndërhyrjen e tij, për zgjidhjen e problemeve dhe shqetësimeve të tyre.

Sugjerim për përmirësime

I. Për sa më sipër, duke analizuar kërkesat e nenit 48 të Kodit të Procedurës Penale, i cili bën fjalë "Mbrotësi i zgjedhur nga i pandehuri" propozojmë të shtohet dhe një pikë tjetër me këtë përmbajtje: ***"Familjarët e viktimave dhe personat e dëmtuar nga kryerja e veprave penale, kanë të drejtë të zgjidhin jo më shumë se dy mbrotësa"***.

Në nenin 58 të Kodit të Procedurës Penale, i cili bën fjalë për të drejtat e personit të dëmtuar nga vepra penale, propozojmë të shtohet një pikë më vete me këtë përmbajtje: ***"Familjarët ose trashëgimtarët e viktimës të dëmtuar nga veprat penale kanë të drejtë që gjatë hetimit dhe gjykimit të çështjes të caktojnë një avokat mbrotës, për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e ligjshëm të viktimës, si dhe për shpërblimin e dëmit të shkaktuar"***

II. Gjatë trajtimit të ankesave të qytetarëve drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, në shumë raste familjarët e viktimave kanë ngritur shqetësimin se organi i Prokurorisë nuk i ka njoftuar lidhur me vendimin e pezullimit të hetimeve.

Për rastet e pezullimit të hetimit, në përgjithësi organi i Prokurorisë nuk njofton apo nuk iu dërgon palëve vendimin përkatës, me arsyetimin se *"ky detyrim nuk parashikohet në nenin 326 të Kodit të Procedurës Penale"*.

Mendojmë se edhe për këtë rast, ashtu si dhe për vendimet e tjera që merr organi i Prokurorisë si, "Vendimi për mosfillimin e procedimit penal" apo dhe "Vendimi për pushimin e çështjes", palët duhet të njoftohen, pasi ata kanë të drejtën ligjore, për t'i kundërshtuar apo ankimuar ato në gjykatë.

Ky detyrim rrjedh dhe për faktin, se palët duhet të njihen me veprimet e nevojshme të kryer nga organi procedues, kërkesë kjo e pikës 2 të nenit 326 të K.Pr.Penale. Në rrethana të tilla qytetarët, bazuar në pikën 5, të nenit 24 të K.Pr.Penale mund t'i drejtohen jo vetëm Gjykatës, por edhe Prokurorit më të lartë, me kërkesë për të ndryshuar ose shfuqizuar vendimin e marrë nga Prokurori më i ulët.

Në praktikën e punës gjatë hetimit të çështjeve penale, në raste të veçanta ndodh kur Prokurori mund të vendosë pushimin e akuzës ndaj personit nën hetim, dhe të pezullojë hetimin e çështjes penale. Për rrjedhojë, palët duhet të njihen me të dy vendimet e marra nga Prokurori në një procedim penal të vetëm.

Jo në pak raste, për ngjarje kriminale që lidhen me humbjen apo zhdukjen e personave, kallëzuesit nuk janë njohur me vendimin e pezullimit të hetimit. Shprehim mendimin se ata duke qënë persona të interesuar në procesin penal, duhet të njoftohen me vendimin e pezullimit të hetimeve, pasi duke marrë informacionin e nevojshëm kanë dhe detyrime të tjera ligjore siç është ai që parashikohet në nenin 15 të Kodit Civil të Republikës të Shqipërisë, për t'ju drejtuar Gjykatës me kërkesë, e mandej ajo të marrë vendim për shpalljen e zhdukur të personit.

Për rrjedhojë, mendojmë se e drejta e ankimit të qytetarëve, kallëzues dhe familjarëve të viktimave duhet të përfshihet edhe për rastet kur organi i Prokurorisë vendos pezullimin e hetimeve. Prandaj, propozojmë që tek neni 326 i Kodit të Procedurës Penale, i cili bën fjalë për pezullimin e hetimeve, të shtohet në nenin 326/a, me këtë përmbajtje: ***"Ankimi kundër vendimit të***

pezullimit të hetimeve” dhe tek pika 1 e tij: *“Kundër vendimit të pezullimit të hetimeve mund të bëjnë ankim në gjykatë, familjarët e viktimave apo të dëmtuarve nga vepra penale”.*

Në bazë të nenit 63/3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* si dhe nenit 24/a të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* me ndryshimet përkatëse, ku thuhet se: *“ Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre, shkaku që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut , të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera , ka të drejtë : a.t’u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjëvënëse të bëjnë propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve”,*

REKOMANDOHE T

“Të propozohen shtesa dhe përmirësime në nenet 48, 58 dhe 326 të Kodit të Procedurës Penale, për vendosjen e avokatit mbrojtës në procedimin dhe gjykimin penal, për mbrojtjen e interesave të ligjshëm të viktimës si dhe ankimit ndaj vendimit të pezullimit të hetimeve, marrë nga organi i Prokurorisë”.

Mbi mënyrën e shqyrtimit dhe masat e marra për Rekomandimin, lutemi të njoftohemi brënda 30 ditëve , kërkesë kjo e parashikuar në nenin 22 të ligjit *“Për Avokatin e Popullit”*.

Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj,

Me respekt

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI